



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS

Gjuhë C (4)

Ngarkesa: 4 kredite, 40 seminare
Viti / Semestri: Viti II, semestri II
Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme
Programi i studimit: Bachelor, GjuhëAngleze

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Lënda Gjuha Angleze si Gjuhë e Dytë synon t'u ofrojë studentëve një bazë të qëndrueshme njohurish gjuhësore dhe komunikative për përdorimin e anglishtes në situata të përditshme. Qëllimi kryesor është zhvillimi i kompetencave bazë në të katër aftësitë gjuhësore: të kuptuarit me dëgjim, të lexuarit, të folurit dhe të shkruarit.

Objektivat specifike lëndore:

- 1.Në përfundim të kursit, studentët do të jenë në gjendje:
- 2.Të komunikojnë në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme në situata të zakonshme të jetës së përditshme.
- 3.Të aplikojnë rregullat bazë të gramatikës angleze në komunikim dhe në shkrim.
- 4.Të përdorin anglishten për të lexuar dhe shkruar tekste të thjeshta, si letra, mesazhe, përshkrime dhe tregime.

*Rezultatet të pritshme :*Në përfundim të kursit, studentët pritet të jenë në gjendje:

- 1.Të pyesin dhe të përgjigjen në gjuhën angleze për tema të ndryshme të jetës së përditshme me saktësi dhe rrjedhshmëri.
- 2.Të zhvillojnë dialogë të thjeshtë dhe të komunikojnë me folës të tjerë të gjuhës angleze pa vështirësi të kuptimit.
- 3.Të marrin pjesë në diskutime për tema të përzgjedhura, duke shprehur mendimet e tyre në mënyrë të qartë.
- 4.Të përdorin konceptet bazë të gjuhës angleze në dokumente zyrtare e jozyrtare (letra, email-e, shënime, tregime).